

## KONTRATË SHIT-BLERJE KUOTE

nga dhe midis

**TOBACCO HOLDING GROUP SHPK**, person juridik shqiptar, regjistruar më 24.05.2001 me NUIS K11724001B, me seli në Adresën: Njësia Bashkiake Nr.6, Rr. "Feridon Fezollari", Ndërtesa THG, Ish Kombinati Ushqimor, Zona Kadastrale Nr.8240, Nr.Pas.2/163, Tiranë, përfaqësuar nga administratorja Valbona Begu në vijim ("**Shitësi**").

Dhe

**Shkëlqim Devolli**, shtetas i Republikës së Kosovës, lindur më 05.08.1979, me adresë në Rr. "Lekë Dukagjini", Nr. 27, Pejë, Kosovë, identifikuar me pasaportën nr. P00352049, në vijim ("**Blerësi**").

Shitësi dhe Blerësi në vijim referuar edhe individualisht si "**Palë**" dhe kolektivisht si "**Palët**".



## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1</b>	<b>PËRCAKTIMET DHE INTERPRETIMI</b> .....	<b>3</b>
1.1	Përcaktime.....	3
1.2	Interpretimi .....	4
<b>2</b>	<b>OBJEKTI I KONTRATËS</b> .....	<b>4</b>
<b>3</b>	<b>ÇMIMI I SHITJES DHE PAGESA</b> .....	<b>4</b>
3.1	Çmimi i Shitjes.....	4
3.2	Pagesa e Çmimit të Shitjes .....	4
<b>4</b>	<b>TRANSFERIMI I KUOTËS NË SHITJE</b> .....	<b>4</b>
4.1	Transferimi i Kuotës në Shitje .....	4
4.2	Regjistrimi i transferimit pranë QKB .....	5
<b>5</b>	<b>DEKLARIMET E SHITËSIT</b> .....	<b>5</b>
5.1	Pronësia e Kuotës në Shitje.....	5
5.2	Statusi ligjor i Kuotës në Shitje.....	5
5.3	Deklarime të tjera të Shitësit .....	5
<b>6</b>	<b>DEKLARIMET E BLERËSIT</b> .....	<b>6</b>
<b>7</b>	<b>MIRATIMI I SHIT-BLERJES NGA ANA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË</b> .....	<b>6</b>
<b>8</b>	<b>KOSTOT</b> .....	<b>6</b>
8.1	Tarifat e Konsulentëve.....	6
8.2	Taksat e zbatueshme .....	6
8.3	Tarifat Publike .....	7
<b>9</b>	<b>KONFIDENCIALITETI</b> .....	<b>7</b>
9.1	Konfidencialiteti.....	7
<b>10</b>	<b>LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI</b> .....	<b>7</b>
10.1	Ligji i Zbatueshëm .....	7
10.2	Juridiksioni.....	7
<b>11</b>	<b>TË NDRYSHME</b> .....	<b>7</b>
11.1	Forma e Shkruar.....	7
11.2	Gjuha.....	7
11.3	Njoftimet .....	8



## Hyrje

### MEQËNËSE:

- (A) Shitësi dhe Blerësi janë ortakë në shoqërinë DE HOLDING SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me numër unik identifikimi NUIS L71402065J, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("**QKB**"), Tiranë, Shqipëri, me adresë në Njësia Bashkiake Nr. 6, Rruga Feridon Fezollari, Ndërtesa THG, Tiranë, Shqipëri, me kapital 300,000 lekë, të paguar plotësisht, në vijim ("**Shoqëria**");
- (B) Shitësi zotëron një kuotë në para të kapitalit të Shoqërisë, që rezulton në një pjesëmarrje prej 50% në kapitalin e Shoqërisë, në vlerën 150,000 lekë "**Kuota e Shitjes**";
- (C) Blerësi po ashtu zotëron një kuotë në para të kapitalit të Shoqërisë, që rezulton në një pjesëmarrje prej 50% në kapitalin e Shoqërisë, në vlerën 150,000 lekë;
- (D) Shitësi bie dakord t'i shesë Blerësit Kuotën e Shitjes, dhe Blerësi bie dakord të blejë këtë Kuotë, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuar në vijim në këtë kontratë shit-blerje kuote ("**Kontrata**")

PRANDAJ, nisur nga sa më sipër, Palët bien dakord si në vijim:

## 1 Përcaktimet dhe Interpretimi

### 1.1 Përcaktime

Në këtë Kontratë, përveç kur konteksti mund të kërkojë ndryshe, fjalët dhe shprehjet e listuara në tabelën më poshtë do të kenë kuptimin që i është caktuar këtu:

<b>Kontratë</b>	do të thotë kjo kontratë për shit-blerjen e Kuotës në Shitje
<b>Qendra Kombëtare e Biznesit</b>	do të thotë Qendra Kombëtare e Biznesit, e themeluar dhe që funksionin sipas Ligjit 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i amenduar
<b>Regjistri i Barrëve Siguruese</b>	do të regjistri për regjistrimin e barrëve siguruese, i krijuar dhe që funksionon në përputhje me Ligjin 8537 datë 18.10.1999 "Për barrët siguruese", i amenduar
<b>Regjistri Tregtar</b>	do të thotë regjistri tregtar i mbajtur dhe i administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>Sekreti Tregtar</b>	do të thotë sekreti tregtar sipas përcaktimit të nenit 111/a të Ligjit 9947 datë 07.07.2008 "Për pronësinë industriale", i ndryshuar.



## 1.2 Interpretimi

- 1.2.1 Tabela e përmbajtjes dhe titujt e neneve janë vetëm për lehtësi referencë dhe nuk do të modifikojnë, ndryshojnë, shtojnë ose kufizojnë ndonjë prej neneve këtu.
- 1.2.2 Përvec kur konteksti qartësisht e kërkon ndryshe, fjalët që tregojnë numrin njëjës do të përfshijnë dhe numrin shumës dhe *vice versa*.
- 1.2.3 Kudo në këtë Kontratë ku referohet se një Palë "merr përsipër" që një veprim specifik të ndërmerret ose që një rezultat specifik të arrihet, kjo referencë do të interpretohet si një detyrim i pakushtëzuar nga ana e Palës që Palë të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore në kontrollin e saj ose në kontrollin e ndonjë prej palëve të lidhura me të që të sigurojnë që veprimi përkatës të ndërmerret ose rezultati përkatës të arrihet.

## 2 Objekti i Kontratës

- 2.1 Sipas kushteve dhe termave të parashikuara në këtë Kontratë, Shitësi shet në mënyrë të parevokueshme nëpërmjet kësaj Kontrate dhe transferon tek Blerësi Kuotën e Shitjes dhe Blerësi blen dhe pranon transferimin e Kuotës në Shitje nga Shitësi.

## 3 Çmimi i Shitjes dhe Pagesa

### 3.1 Çmimi i Shitjes

Çmimi i Shitjes për Kuotën e Shitjes është 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) Euro.

### 3.2 Pagesa e Çmimit të Shitjes

Palët bien dakort që pagesa e Çmimit të Shitjes të fillojë menjëherë sapo të ketë përfunduar pagesa për kthimin e huasë sipas kontratës për kthimin e huasë midis DE Holding SHPK dhe Shitësit. Palët bien dakord që pagesa nga ana e Blerësit të Çmimit të Shitjes do të kryhet e shtrirë në një periudhë prej 12 muajsh me këste mujore prej 100,000 Euro cdo muaj të njëpasnjëshëm. Pagesa e parë do të bëhet në muajin Mars 2023 dhe do të vijojë të paguhet cdo muaj të njëpasnjëshëm në datën 10 apo ditën e punës së ardhshme, nësa data 10 është pushim, në përputhje me Ankesin e Kontratës "Grafiku i Pagesave" deri sa të plotësohet shuma prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) Euro. Pagesa do të kryhet në llogarinë bankare të Shitësit, me të dhënat si vijon: OTP BANK ALBANIA Sha., IBAN AL91 2131 1044 0000 0000 0124 7601.

## 4 Transferimi i Kuotës në Shitje

### 4.1 Transferimi i Kuotës në Shitje

Pronësia e Kuotës në Shitjes transferohet në favor të Blerësit në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga ana e Palëve. Konkretisht me nënshkrimin e



Kontratës nga Palët, që përbën edhe datën në të cilën Kontrata është efektive, pronësia e Kuotës në Shitje transferohet në favor të Blerësit dhe struktura e kapitalit të Shoqërisë bëhet si në vijim:

Ortaku	Pjesëmarrja në kapital	Kapitali
Shkëlqim Devolli	100%	300,000 lekë

#### 4.2 Regjistrimi i transferimit pranë QKB

Menjëherë pas nënshkrimit të Kontratës, Blerësi i drejtohet QKB-së duke kërkuar depozitim të kësaj Kontrate pranë Regjistrin Tregtar dhe kryerjen e ndryshimeve përkatëse në këtë Regjistër, duke i kërkuar edhe administratorëve të Shoqërisë që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të realizuar depozitim dhe regjistrimin përkatëse të ndryshimeve në Regjistrin Tregtar.

### 5 Deklarimet e Shitësit

#### 5.1 Pronësia e Kuotës në Shitje

Shitësi deklaron dhe garanton se është pronar i vetëm ligjor me të drejta të plota mbi Kuotën në Shitje, se kjo Kuotë është nënshkruar rregullisht dhe paguar plotësisht nga ana e tij në momentin e themelimit të Shoqërisë, dhe është e regjistruar në pronësi të tij pranë Regjistrin Tregtar të mbajtur nga QKB, fakt që vërtetohet nëpërmjet ekstraktit të lëshuar nga QKB në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, i cili bashkëlidhet këtu si **Shtojca 1**.

#### 5.2 Statusi ligjor i Kuotës në Shitje


Shitësi në vijim deklaron se Kuota në Shitje është e lirë nga cdo lloj pengu, barre apo kufizimi tjetër ligjor, i cfarëdo lloj natyre qoftë, dhe nuk është përdorur asnjëherë si mjet për sigurimin e ndonjë detyrimi. Në mbështetje të deklarimeve të mësipërme Shitësi paraqet në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ekstraktin nga Regjistri i Barrëve Siguruese ("RBS") në lidhje me statusin ligjor të Kuotës në Shitje, që i bashkëlidhet kësaj Kontrate si **Shtojca 2**.

#### 5.3 Deklarime të tjera të Shitësit

Shitësi më tej deklaron dhe garanton se:

- Shoqëria është një shoqëri që funksionin rregullisht sipas legjislacionit shqiptar;

- Ndaj Shoqërisë nuk është marrë asnjë lloj mase administrative nga organet publike ligj-zbatuese shqiptare, në mënyrë të veçantë Shoqëria nuk ka procese të hapura administrative apo gjyqësore me organet tatimore dhe drejtoritë e



taksave vendore sipas vendeve ku ushtron aktivitetin, Shoqëria nuk është përfshirë në asnjë lloj mosmarrëveshje në lidhje me themelimin e saj apo me personat që kanë ushtruar detyra drejtuese në Shoqëri si dhe ka depozituar rregullisht në QKB bilancet vjetore sipas legjislacionit të zbatueshëm;

- Shoqëria ka regjistruar rregullisht pronarët përfitues në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm;

- Shitësi ka paguar rregullisht të gjitha taksat që lidhen me pronësinë mbi Kuotën deri në momentin e transferimit të saj tek Blerësi;

- Shitësi me nënshkrimin e kësaj Kontrate pranon transferimin e Kuotës së Shitjes tek Blerësi së bashku me të gjitha të drejtat që rrjedhin nga pronësia mbi Kuotën në Shitje, përfshirë të drejtën e votës dhe të dividendit në Shoqëri, të cilat i kalojnë dhe i përkasin Blerësit. Shitësi deklaron dhe pranon se nuk ka asnjë pretendim, të tanishëm apo të ardhshëm, në lidhje me dividendin apo fitimin e akumuluar në Shoqëri, dhe se Cmimi i Shitjes përbën kompesimin e plotë dhe përfundimtar të Shitësit në lidhje me shitjen dhe transferimin e Kuotës në Shitje në favor të Blerësit;

- Shitësi ka të drejtat dhe autoritetin e mjaftueshëm për të lidhur këtë Kontratë dhe për të marrë përsipër transksionet që parashikohen këtu.

## 6 Deklarimet e Blerësit

Blerësi deklaron dhe garanton se ka të drejtat dhe autoritetin e mjaftueshëm për të lidhur këtë Kontratë dhe për të marrë përsipër transksionet që parashikohen këtu.

## 7 Miratimi i shit-blerjes nga ana e asamblesë së përgjithshme të Shoqërisë

Shitësi dhe Blerësi, në cilësinë e ortakëve të Shoqërisë, marrin përsipër që të miratojnë këtë Kontratë duke shprehur vullnetin e tyre për shit-blerjen dhe transferimin e Kuotës në Shitje edhe në cilësinë e ortakëve të Shoqërisë, duke nënshkruar dhe miratuar vendimin e asamblesë së përgjithshme të Shoqërisë, i cili i bashkëlidhet kësaj Kontrate si **Shtojca 3**.

## 8 Kostot

### 8.1 Tarifat e Konsulentëve

Secila Palë do të paguajë tarifrat dhe shpenzimet e kryera prej saj në lidhje konsulencën ligjore dhe fiskale që ka marrë për realizimin e transaksionit të parashikuar në këtë Kontratë.

### 8.2 Taksat e zbatueshme

Shitësi dhe Blerësi do të paguajnë individualisht në mënyrë të pavarur taksat përkatëse që zbatohen në lidhje me shit-blerjen dhe transferimin e Kuotës në Shitje sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.



### 8.3 Tarifat Publike

Tarifa noteriale, nëse ka, tarifat e transferimit pranë QKB si dhe tarifa për lëshimin e ekstraktit pranë RBS do të paguhen nga Shoqëria.

## 9 Konfidencialiteti

### 9.1 Konfidencialiteti

Secila prej Palëve do të ruajë si konfidencial informacionin që ka marrë në lidhje me këtë Kontratë, biznesin e Palëve apo cdo informacion tjetër që konsiderohet i rëndësishëm nga Palët, përsa kohë ky informacion nuk është paraprakisht i disponueshëm publikisht. Në mënyrë të vecantë Shitësi merr përsipër të mos shpërndajë, të mos bëjë publike në mënyrë të pa-autorizuar dhe në përgjithësi mos të përdorë sekretin tregtar të Blerësit apo të Shoqërisë.

## 10 Ligji i Zbatueshëm dhe Juridiksioni

### 10.1 Ligji i Zbatueshëm

Kjo Marrëveshje dhe marrëdhëniet midis Palëve do të rregullohen nga Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

### 10.2 Juridiksioni

Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me këtë Kontratë do të zgjidhet përfundimisht përpara gjykatave përkatëse në përputhje me rregullat mbi juridiksionin dhe kompetencën që përmban Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

## 11 Të ndryshme

### 11.1 Forma e Shkruar

Asnjë amendim, modifikim apo ndryshim i Kontratës nuk do të jetë i vlefshëm përveç në formë të shkruar, i regjistruar në një dokument të vetëm dhe i nënshkruar nga ose në emër të secilës prej Palëve në të.

### 11.2 Gjuha

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe.



## 11.3 Njoftimet

13.5.1 Një njoftim sipas kësaj Kontrate në favor të Shitësit, do të bëhet në vëmendje të:

Valbona Begu

e-mail: valbona\_begu@thg-shpk.com

13.5.2 Një njoftim sipas kësaj Kontrate në favor të Blerësit, do të bëhet në vëmendje të:

Arbër Salihu

e-mail: arber.salihu@comoditahome.com

Data 7 Prill 2022

**PALËT**

**TOBACCO HOLDING GROUP SHPK**

*Valbona Begu*



*Valbona Begu*



**Z. Shkëlqim Devolli**

*SHKELQIM DEVOLLI*





## ANEKSI I KONTRATËS

## GRAFIKU I PAGESAVE

Nr. i këstit	Datë pagese	Huaja e mbetur (euro)	Huaja e Paguar (euro)
<b>Data e lidhjes se kontratës</b>		<b>1,200,000</b>	
1	10.03.2023	1,100,000	100,000
2	10.04.2023	1,000,000	100,000
3	10.05.2023	900,000	100,000
4	12.06.2023	800,000	100,000
5	10.07.2023	700,000	100,000
6	10.08.2023	600,000	100,000
7	11.09.2023	500,000	100,000
8	10.10.2023	400,000	100,000
9	10.11.2022	300,000	100,000
10	11.12.2023	200,000	100,000
11	10.01.2024	100,000	100,000
12	12.02.2024	0	100,000
<b>TOTAL</b>			<b>1,200,000</b>



**Lista e Shtojcave**

- |           |                                  |
|-----------|----------------------------------|
| Shtojca 1 | Ekstrakti i Shoqërisë            |
| Shtojca 2 | Ekstrakti i RBS                  |
| Shtojca 3 | Vendimi i Asamblesë së Shoqërisë |

Shtojca 1

.....



Shtojca 2

.....

*Handwritten signature in blue ink, possibly reading "Kongoli" or similar.*



*Handwritten signature in blue ink, overlapping the bottom of the stamp.*